

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 62, datë 25.06.2024



PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 61, DATË 28.02.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. SABRIJE KOTOBELLI, Z. MURAT KOTOBELLI, ZNJ. VITRIJE KOTOBELLI, Z. GEZIM KOTOBELLI, Z. KRESHNIK KOTOBELLI, Z. XHEVAHIR KOTOBELLI, ZNJ. NAILE KOTOBELLI DHE ZNJ.ALESSIA KOTOBELLI SI DHE PËRSA I PËRKET Z. SYBI NANUSHI, ZNJ.AFËRDITA NANUSHI, Z. ILIRJAN NANUSHI DHE Z. EDVALDO NANUSHI

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i Njesisë Administrative si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga Programet e Rindërtimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësine Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr.135,

datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë Durrës “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, i ndryshuar si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023 përsa i përket përfshirjes si përfitues të znj. Sabrije Kotobelli, z. Murat Kotobelli, znj. Vitrije Kotobelli, z. Gezim Kotobelli, z. Kreshnik Kotobelli, z. Xhevahir Kotobelli, znj. Naile Kotobelli dhe znj. Alessia Kotobelli, në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Sybi Nanushi, znj. Afërdita Nanushi, z. Ilirjan Nanushi dhe z. Edvaldo Nanushi në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit si dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.06.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 389 prot.

Durrës, më 01.07.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.62 datë 25.06.2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e këshillit bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023 përsa i përket znj. Sabrije Kotobelli, z. Murat Kotobelli, znj. Vitrije Kotobelli, z. Gezim Kotobelli, z. Kreshnik Kotobelli, z. Xhevahir Kotobelli, znj. Naile Kotobelli dhe znj. Alessia Kotobelli si dhe përsa i përket z. Sybi Nanushi, znj. Afërdita Nanushi, z. Ilirjan Nanushi dhe z. Edvaldo Nanushi”,

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) i ndryshuar “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

